



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA**  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA**

**AD/GJTHPR/14/24**

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga Kallxo.com përmes përfaqësuesit të zyrës ligjore ndaj gjyqtarit B.A, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 15.07.2024 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga Kallxo.com përmes përfaqësuesit të zyrës ligjore ndaj gjyqtarit B.A, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankesës Kallxo.com përmes përfaqësuesit të zyrës ligjore me datë 20.06.2024 përmes adresës elektronike ka paraqitur ankesë disiplinore kundër gjyqtarit B.A. Në lidhje me pranimin e ankesës, me datë 21 Qershor 2024 është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Parashtruesi i ankesës ka paraqitur ankesë disiplinore për gjyqtarin B.A, për shkak të pretendimeve se gjyqtari B.A gjatë trajtimit të rastit lidhur me veprën penale “Kanosja” ndaj të akuzuarit A.P, ka ndërmarrë veprime të pa-renditura sipas Kodit të Procedurës Penale. Sipas parashtruesit të ankesës, gjyqtari i vetëm gjykues B.A gjatë mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 20.06.2024 ka bërë shkelje të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale ashtu që ka bërë aprovimin e pranimin të fajësisë nga i akuzuari A.P, ndonëse deklarimi i të akuzuarit lidhur me veprën ka pasur mangësi të dukshme. Tutje parashtruesi i ankesës ka deklaruar se pasi është lexuar aktakuza nga prokurorja i pandehuri është thirrur që të deklarohet lidhur me pranimin e fajësisë ashtu siç parashihet me Kodin e Procedurës Penale, meqë rast i pandehuri është deklaruar “*e pranoj fajësinë, se ma ka pru nxitja, aq ma ka pru nxitja tu vozit, edhe aty jam shpreh (nuk kuptohet) Unë e pranoj fajësinë çka jam sha, por te fajësia për me arrit te qikjo çka unë po e pranoj fajësinë u kon nxitja në tjetrën anë*” ka thënë i akuzuari”. Me këtë rast, gjyqtari i çështjes e ka konstatuar në procesverbal vetëm këtë fjali lidhur me deklarimin e të akuzuarit për pranimin e fajësisë “*E pranoj që e kam sharë dhe e kam fyer, po e pranoj fajësinë*”.

Tutje ka deklaruar se i pandehuri akuzohet që e ka kanosur gazetaren e Kallxo.com, të dëmtuarën A.B dhe nuk akuzohet për sharje a po fyerje pasi që nuk ekziston veprë penale që do të parashihte fyerjen. Andaj mbi bazën e kësaj, deklarimi për pranimin ose jo të fajësisë do të duhej të bëhej lidhur me veprën penale të kanosjes, jo në drejtim të fyerjeve dhe sharjeve.

Sipas parashtruesit të ankesës, gjyqtari B.A nuk ka zbatuar siç duhet dispozitën e nenin 242 “Pranimi i fajësisë dhe shqiptimi i sanksionit penal gjatë shqyrtimit fillestar”, kur ka marrë vendim që ti aprovohet pranimi i fajësisë të akuzuarit, në vend që ti refuzohet pranimi i fajësisë, pasi që ka qenë e

paqartë dhe diskutabile nëse i njëjti e ka pranuar përshkrimin si në dispozitiv të aktakuzës a po ka pranuar vetëm shprehjet fyese që i ka thënë.

Përveç kësaj, parashtruesi i ankesës deklaroi se gjyqtari B.A i tërheq vërejtjen pjesëtarëve të mediave dhe monitoruesve që të pandehurit të mos i publikohet fytyra e as të dhënat personale të palëve prezentë në këtë procedurë, duke e kufizuar publicitetin në publikim të mediave, ndonëse seanca ka qenë e hapur për publikun. Ky veprim i gjyqtarit pa marrë aktvendim procedural por vetëm njoftim verbal nuk gjen mbështetje në Kodin e Procedurës Penale dhe njëherazi është kontradiktor në vete pasi që në një paragraf më lartë gjyqtari ka konstatuar se seanca është publike.

Në fund ka deklaruar se veprime të tilla të lartë shënuara dhe të provuara, përpos që dekurajojnë qytetarët ti ndjekin procedurat gjyqësore, ndikojnë negativisht edhe në besimin ndaj sistemit të drejtësisë përgjithësisht nga ana e shoqërisë.

Në lidhje me pretendimet e paraqitësit të ankesës, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se Prokuroria Themelore në Prishtinë, me datë 20.09.2022, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën me numër PP.II.nr.4257/22, kundër të pandehurit A.P, në drejtim të veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 1 të KPRK-së. Senca e shqyrtimit fillestar është caktuar dhe mbajtur me datë 20.06.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar palët e cekura si në procesverbalin e kësaj seance. Tutje gjyqtari ka deklaruar se në këtë seancë, pasi që ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për mbajtjen e të njëjtës, ka marr aktvendim procedural me të cilën ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për mbajtjen e kësaj seance dhe ashtu siç e rregullojnë dispozitat ligjore ka dhënë udhëzimet për palët dhe për publikun që kanë qenë në sallë, në atë mënyrë që duke pasur për bazë ruajtjen e informacioneve të cilat nuk duhen të publikohen për të akuzuarin, ka dhënë njoftimet e nevojshme.

Tutje gjyqtari ka deklaruar se pas leximit të aktit akuzues nga ana e Prokurores së çështjes dhe pas dëgjimit të palëve, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e pranimin të fajësisë për të pandehurin A.P, andaj ka marr aktvendim procedural me të cilën ka aprovuar pranimin e fajësisë për të pandehurin dhe se nga palët prezentë në këtë nuk pa pasur asnjë vërejtje, fakt ky që vërtetohet edhe në bazë të procesverbalit të datës 20.06.2024, i cili procesverbal është nënshkruar po ashtu pa asnjë vërejtje nga palët prezentë.

Sipas gjyqtarit, me datë 21.06.2024, ka bërë shpalljen e aktgjykimit, me të cilin të akuzuarin e ka shpallur fajtor dhe të njëjti i ka caktuar dënimin konform dispozitave ligjore, ku njëherit i ka njoftuar palët se aktgjykimin do ta pranojnë brenda afatit ligjor në formë të shkruar, e ndaj të cilit mund të paraqitet ankesë në afat prej 30 ditësh pas pranimin të të njëjtit.

Lidhur me pretendimet e paraqitura nga ankuesi se si gjyqtar i çështjes ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale lidhur me pranimin e fajësisë për të pandehurin, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet ankuesit, pasi që është në diskrecionin e gjyqtarit që të vlerësojë nëse janë përmbushur apo jo kushtet për aprovimin e fajësisë, diskrecion ky që derivon në bazë të ligjit, e në rast që pranimi i fajësisë nuk është bërë konform dispozitave ligjore, atëherë sipas legjislacionit në fuqi palët e autorizuar kanë të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit e cila lidhur me këtë çështje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare.

Tutje ka deklaruar se sa i përket pretendimet se *“deklarimi për pranimin e fajësisë ose jo të fajësisë do të duhej të bëhej lidhur me veprën penale të kanosjes, jo në drejtim të fyerjeve dhe sharjeve, pasi që siç e dimë fyerjet dhe sharjet hyjnë në spektrin e çështjeve civile”*, pretendim ky i pakuptimtë, pasi që ankuesi në këtë rast nuk ka qenë palë e dëmtuar në këtë çështje penale, por që në këtë seancë kanë prezantuar në cilësi të publikut, andaj gjyqtari ka deklaruar se lidhur me këtë pretendim nuk konsideron se duhet të jap më shumë shpjegime.

Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të ankesës se gjyqtari “i ka dalur në krah” të akuzuarit dhe se këtë e ka bërë duke ia tërhequr vërejtjen pjesëtarëve të mediave që të mos publikohen të dhënat e të akuzuarit, gjyqtari ka deklaruar se këtë veprim e ka ndërmarrë për arsye të qetësimit të situatës në seancë, për faktin se i pandehuri ka qenë i irrituar për prezencën e mediave duke pretenduar se mediat i kanë shkaktuar probleme të shumta në familje deri pothuajse në ndarje nga bashkëshortja e tij ku edhe ka kërkuar që të mos lejohen mediat në këtë seancë, por që sipas gjyqtarit në asnjë moment nuk i ka ndaluar mediat që të marrin informatat e nevojshme nga seanca, por vetëm ka kërkuar nga kamerat që të fokusohen në drejtimin e tij. Pavarësisht vërejtjeve gojore dhe përderisa nuk ka pasur vendim të shkruar për kufizimin apo të ngjashme për mediat, sipas gjyqtarit të njëjtit kanë pasur mundësinë që konform dispozitave ligjore që të veprojnë në këtë seancë, pasi që siç është e konstatuar edhe në procesverbal seanca ka qenë publike dhe se është konstatuar edhe prezenca e mediave në këtë seancë.

Në fund ka deklaruar se duke u bazuar në të lartcekurat konsideron se në këtë çështje penale ka vepruar konform dispozitave ligjore procedurale dhe konform autorizimeve të cilat i garantohen me ligj, ku në bazë të pikës 2 të Kodit të Etikës për Gjyqtar parashihet se “Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, trajtojnë të gjitha palët në procedurë më mënyrë të barabartë pa favorizime, anime dhe paragjykimë. Gjatë gjithë kohës gjyqtari është i paanshëm dhe duhet të duket i paanshëm. Paanshmëria ka të bëjë jo vetëm me vendimin, por edhe me procedurën e marrjes së vendimit”, parim ky të sipas gjyqtarit me përpikëri e zbaton në secilën seancë gjyqësore, pa marrë parasysh nëse janë prezent mediat apo jo.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit B.A.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L – 057, të cilat janë: dënimi për një vepër penale; shkelja e ligjit, ose shkelja e detyrave të tij zyrtare si gjyqtar.

Në lidhje me pretendimin e paraqitur nga ankuesi se gjyqtari i çështjes ka bërë aprovimin e pranimi të fajësisë edhe pse nuk janë plotësuar kushtet të cilat parashihen me legjislacionin në fuqi, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, Kryetarja e Gjykatës ka gjetur se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është zhvilluar në bazë të dispozitave ligjore të parapara me nenin 242 të Kodit të Procedurës Penale, meqë rast në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është deklaruar edhe Prokurori i Shtetit dhe pala e dëmtuar, të cilët nuk e kanë kundërshtuar pranimin e fajësisë nga i njëjtit.

Sa i përket pretendimit të ankuesit se me rastin e pranimi të fajësisë, i pandehuri është deklaruar se “*e pranoj fajësinë, se ma ka pru nxitja tu vozit, edhe aty jam shpreh(nuk kuptohet) unë e pranoj fajësinë çka kam sha, por te fajësia për me arrit te qikjo çka unë po e pranoj fajësinë u kon nxitja tjetrën anë*”, Kryetarja e Gjykatës ka gjetur se gjyqtari i çështjes ka vepruar në bazë të dispozitës së paraparë me paragrafin 3 të nenit 242 të KPPRK-së ku përcaktohet se gjatë diskutimit ndërmjet gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues me të pandehurin në lidhje me bazën faktike për pranimin e fajësisë, mospranimi i çdo pretendimi në aktakuzë lidhur me mënyrën se si është kryer vepra penale nuk do të jetë arsye për të refuzuar pranimin e fajësisë, nëse pranimi nga i pandehuri e vërteton çdo element të veprës penale.

Në rastin konkret, dispozitat e nenit 242 të KPPRK-së, i japin autorizimin e plotë gjyqtarit të çështjes që të vlerësoj nëse duhet të miratohet ose jo pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, andaj një kompetencë e tillë ekskluzive e dhënë vetëm gjyqtarit të çështjes, nuk mund të jetë pretendim për shkelje disiplinore, kjo pasi që Kryetarja e Gjykatës si autoritet kompetent për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore nuk ka kompetencë të vlerësoj a po komentoj vendimet e gjyqtarëve të marra gjatë shqyrtimit

të çështjes gjyqësore, vendime këto që hyjnë në autorizimet e tyre të dhëna me legjislacionin në fuqi. Kjo kompetencë i takon vetëm gjykatës së shkallës së dytë, që të vlerësoj nëse si rezultat i shkeljeve procedurale a po materiale të bëra nga gjykata e shkallës së parë është bërë konstatim i gabuar i gjendjes faktike a po është shkelur ligji.

Për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtarët veprojnë konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi. Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë”, e po ashtu parimi i njëjtë mbrohet edhe nga instrumentet ndërkombëtare ku në Deklaratën Universale mbi Pavarësinë e Gjyqtareve, ku parashihet: "Gjykatësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre duhet të jenë të lirë për të vendosur mbi çështjet në mënyrë të paanshme, në përputhje me vlerësimin e tyre të lirë të fakteve dhe të kuptuarit e tyre të ligjit”.

Sa i përket pretendimit se gjyqtari i çështjes ka shkelur parimin e publicitetit duke deklaruar në fillim se seanca është publike e më pas duke kufizuar mediat në ruajtjen e konfidencialitetit të të pandehurit, në bazë të deklaratës së gjyqtarit por edhe procesverbalit të seancës së datës 20.06.2024, shihet se në hapje të seancës, pas kërkesës së të pandehurit, gjyqtari i çështjes ka konstatuar se seanca është publike dhe është e lejuar fotografimi dhe regjistrimi, por duke i njoftuar mediat që të kenë kujdes që të mos publikohen të dhënat personale të palëve në procedurë.

Gjyqtari i çështjes është i detyruar të kujdeset për zbatimin e akteve normative në mbajtjen e rendit në gjykatore dhe ruajtjen e dinjitetit të gjykatës dhe ka të drejtën e ndërmarrjes së veprimeve në secilin rast që konsideron se ato veprime janë të nevojshme që procedura të zbatohet pa zvarritje, si dhe të kujdeset që të pengojë çdo keqpërdorim të të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk janë shkelur dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

AD/GJTHPR/14/24, me datë 15.07.2024

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë